



Tryeza e rumbullakët

**IDENTIFIKIMI DHE MANIPULIMI ME DISKURSIN PUBLIK POLARIZUES:
DILEMA ETIKE DHE PRAKTIKE**

20 janar 2020 / ora 12 / hoteli "Sollun", Shkup

Të nderuar,

Instituti për shkencë shoqërore dhe humanistike – Shkup (ISSHS), me përkrahje të fondacionit **National Endowment for Democracy (NED)** dhe **Civika Mobilitas**, tre vite me radhë shqyrton projekte të drejtuar kah depolarizimi i hapsirës publike, krijim të supozimeve për pajtim të shoqërisë më të gjërë, si dhe frenim të baticave populiste dhe iliberale në shoqërinë Maqedonase. Në suaza të këtyre projekte, Instituti organizoi takime të numërta, trajnime, puntori dhe konferenca (të mbyllura apo të hapura për publikun) ku diskutoheshin metodat dhe instrumentet e mundshme për depolarizim të diskursit publik dhe normalizimit të rrjedhave shoqërore në vend.

Përveç kësaj, Instituti publikoi dhjetëra studime, analiza të politikave publike dhe informime të shkurtëra në të cilat ofrojmë qasje teoretike dhe praktike ndaj temës (analizat janë në dispozicion në isshs.edu.mk).

Në kontekst të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare (prill, 2020), si dhe në pritje të radikalizimit plotësues të diskursit publik midis aktorëve politik, por dhe në përgjithësi në hapsirën publike, Instituti organizon tryezë të rumbullakët në temë **"identifikimi dhe manipulimi me diskursin publik polarizues: dilema etike dhe praktike"**.

Në tryezën e rumbullakët do të prezantohen dhe diskutohen instrumentet efektive për themelimin e normave dhe rregullave në kontekst të polarizimit radikal në shoqëri, do të diskutohen modalitetet për ballafaqim me polarizimin ritës në shoqëri, roli i mediave në inkuadrimit të mirsjelljes në diskursin, (de)konstrukcionin e fenomenit të armikut politik etj.

Ngjarja do të mbahet në 20 janar viti 2020, në orën 12 në hotelin "Sollun", Shkup.

Në ngjarjen janë të ftuar gazetarë, reporterë, përfaqësues të shoqatave qytetare si dhe përfaqësues të misioneve diplomatike.

Pjesëmarës të tryezës të rumbullakët janë:

Dr. Gordan Georgiev (ISSHS), hyrës dhe modeator

Dr. Ana Bllazheva (ISSHS), koordinator programik

Katarina Sinadinovska, gazetare, kryetare e Këshillit për etikë në media në Maqedoni

Bobo Hristov, gazetarë, redaktor në televizionin Tellma

Lupço Popovski, gazetar

Goran Momirovski, gazetar në televizionin Alfa

Denis Sulejman, koordinator i projekteve, Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë